

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen dhe dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqeve të kërkuara nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST” sh.a., të prekura nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë Kuqe”, në zbatim të Vendimit nr. 11, datë 28.01.2025, “Për miratimin e lejes së ndërtimit të infrastrukturës për objektin: ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë Kuqe’”.

Propozuesi i projektaktit: Kryetaria e Bashkisë.

Qëllimi: Mbledhjen e komenteve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të komunitetit dhe palëve të interesuara lidhur me “Dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen dhe dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqeve të kërkuara nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST” sh.a., të prekura nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë Kuqe”, në zbatim të Vendimit nr. 11, datë 28.01.2025, “Për miratimin e lejes së ndërtimit të infrastrukturës për objektin: ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë Kuqe’”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet **në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Durrës, kati i dytë në bashkinë Durrës, ora 12:00, datë 14 Shtator.**

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 14 Shtator 2026, në adresën e emailit:

Daniela.Murataj@durres.gov.al, keshillidurres@gmail.com, ornela.marku@durres.gov.al

Organizues :

- Administrata e Bashkisë Durrës dhe Këshilli Bashkiak

Priten rekomandime/sugjerime nga :

- Banorët e Bashkisë Durrës, Personat dhe subjektet që preken apo kanë interes të drejtpërdrejtë nga çështja objekt konsultimi; Institucionet publike dhe strukturat përgjegjëse; Organizatat e shoqërisë civile; Përfaqësues të komunitetit; Ekspertë dhe profesionistë të fushës së mjedisit, pyjeve, energjisë dhe infrastrukturës; Çdo person fizik apo juridik apo grupe të ndryshme interesi.

Forma e konsultimit: Nëpërmjet takimit publik, mbledhjes së sugjerimeve, komenteve dhe rekomandimeve.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e komunitetit dhe palëve të interesuara në procesin e shqyrtimit të materialit lidhur me dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen dhe dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqeve të kërkuara nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST” sh.a., të prekura nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë Kuqe”. Në kuadër të transparencës dhe konsultimit me publikun, palët e interesuara ftohen të njihen me materialin objekt konsultimi dhe të paraqesin komentet, sugjerimet apo vërejtjet e tyre lidhur me çështjen. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, materiali do të vijojë procedurën për t’u përfshirë në rendin e ditës së Këshillit Bashkiak, për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës.
Përshkrimi i çështjes.	Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe në funksion të realizimit të projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë Kuqe”, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit të infrastrukturës me Vendimin nr. 11, datë 28.01.2025, është paraqitur kërkesa nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST” sh.a. për vijimin e procedurave lidhur me sipërfaqet e fondit pyjor të prekura nga realizimi i këtij projekti. Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Bashkia Durrës vlerëson të nevojshme shqyrtimin dhe dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen dhe dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqeve të kërkuara, në funksion të realizimit të projektit të infrastrukturës energjetike. Procesi i konsultimit publik synon garantimin e transparencës dhe të pjesëmarrjes së publikut, duke u krijuar mundësi palëve të interesuara të njihen me materialin dhe të paraqesin komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre përpara vijimit të procedurës për shqyrtim dhe vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak. Qëllimi është: - Dhënia e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen dhe dhënien në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqeve të kërkuara nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST” sh.a., të prekura nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fushë Kuqe”.

	Vizioni është: - Garantimi i transparencës dhe informimit të publikut lidhur me çështjen objekt konsultimi; - Përfshirja e komunitetit dhe palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes; - Marrja në konsideratë e komenteve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë procesit të konsultimit publik; - Vijimi i procedurave administrative në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me kërkesat që lidhen me realizimin e projektit.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresën e email-it më poshtë, brenda datës 14 Shtator 2026. daniela.murataj@durres.gov.al, keshillidurres@gmail.com, ornela.marku@durres.gov.al
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen web të bashkisë, faqja kryesore. https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Administrata e Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit në bashkëpunim me KNJKP i një “Përmbledhje të rekomandimeve dhe rezultateve të plota” që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti. 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetares të Bashkisë, Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetares të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	25.08.2026

